



QENDRA SHQIPTARE PËR KËRKIME EKONOMIKE

Të nderuar miq,

Duke vlerësuar pjesëmarrjen tuaj të deritanishme në forumet publike që Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike ka ndërmarrë, synojmë të nxisim më tej debatin publik me ekspertë të fushave të ndryshme për të promovuar rëndësinë e interpretimit të indekseve globale dhe impaktet e tyre në zhvillimin e politikave eficiente në Shqipëri.

Në kuadrin e implementimit të projektit “Index Albania”, ACER zhvilloi sot një forum të hapur mbi Lirinë e Medias në Shqipëri.

Në këtë forum morën pjesë gazetarë, shoqata profesionale dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët pruan se mungesa e lirisë së medias në Shqipëri është një tregues i mungesës së përgjithshme të lirive qytetare, politike dhe ekonomike që shqetëson të gjithë shoqërinë shqiptare dhe se problemet e medias janë njëkohësisht probleme të të gjithë shqiptarëve.

Me kënaqësi duam t’ju ofrojmë më shumë informacion mbi zhvillimin dhe rezultatet e këtij aktiviteti, duke shpresuar të ndihmojmë sado pak në promovimin e vlerave demokratike, lirisë së mediave dhe progresin ekonomik.

Lexim të mbarë të këtij Buletini...

Sinqerisht,

Dr. Zef PRECI
Drejtor Ekzekutiv

Projekti “Index Albania” është mbështetur nga *Komisioni për Demokraci, Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Tiranë* dhe zbatuar nga *Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike*, duke u konceptuar si një instrument për të rritur shkallën e njohjes mbi metodologjitë e indekseve të botuara nga institucionet më prestigjose në botë.

Kohëzgjatja e Projektit:
Shtator 2008 - Shkurt 2008

Në Fokus:

Freedom House
“Indeksi i Lirisë së Shtypit”, 2008

SHQIPËRIA: Pjesërisht e lirë

ACER

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) është një organizatë e pavarur jo-qeveritare kushtuar nxitjes së zhvillimit të politikave ekonomike të tregut të lirë, mirëqeverisjes, lirisë individuale dhe zhvillimit të marrëdhënieve Euro-Atlantike. Që prej vitit 1992, ACER ka ndërmarrë një sërë projektesh, studimesh dhe vrojtime mbi aspektet kryesore të tranzicionit të Shqipërisë për vendosjen e një ekonomie tregu dhe sistemi demokratik.

Rruga: I. Qemali, Pall.Nr.34/1, Kati V-te, Apt.4
Kutia Postare 2934,
Tiranë, Shqipëri
Tel/Fax: ++ (355-42) 225-021
E-mail: acer@icc-al.org
www.acer.org.al



FORUMI II: LIRIA E SHTYPIT

Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Medias dhe OJQ-ve

Në 15 Tetor, ACER organizoi një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të OJQ-ve, dhe medias për prezantimin e Indeksit mbi Lirinë e Shtypit. Ky aktivitet është i dyti në serinë e aktiviteteve të projektit Index Albania. Folësit e ACER informuan pjesëmarrësit për qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e "Index Albania". Ata prezantuan gjithashtu të dhënat e këtij Indeksi duke ju referuar renditjes që ka marrë Shqipëria, si dhe klasifikimin e saj ndër vendet e rajonit.

INDEKSI "LIRIA E SHTYPIT", FREEDOM HOUSE

Freedom House ka publikuar shumë mjete kritike për të vënë në pah të dhëna nga vëzhgimi i saj vjetor mbi lirinë botërore të medias dhe për të ndihmuar në shpjegimin e zbulimeve më të reja në kontekstin e tyre historik. Vëzhgimi i vitit 2008, i cili jep raporte analitike dhe renditje numerike për 195 vende dhe territore, është pjesë e një procesi që është kryer nga Freedom House që nga viti 1980. Edicioni aktual i vëzhgimit, Liria e Medias 2008, vë në dukje përkeqësimin në shkallë globale gjatë vitit 2007, me tendencë vecanërisht negative në ish-Bashkimin Sovietik, Azi dhe Afrikën nën-Sahariane. Rezultati shënon vitin e gjashtë rradhazi në përkeqësim në nivelin e lirisë së medias në shkallë botërore, ku në disa vende e rajone, vërehet përkeqësim i konsiderueshëm. Përmirësimet në disa vende u harruan nga sulmi i vazhdueshëm dhe i pandërprerë mbi median e pavarur nga një numër i madh aktorësh, qoftë shtete autoritare ashtu edhe vende me klimë relativisht pozitive ndaj medias.

www.freedomhouse.org

SHQIPËRIA DHE INDEKSIMI I LIRISË SË SHTYPIT

Raporti vjetor 2008 rradhit Shqipërinë në vendin e 105-të, të fundit në Rajon, ndërkohë që Finlanda dhe vendet e tjera nordike kryesojnë renditjen.

Klima ligjore:	16
Klima politike:	16
Klima ekonomike:	18

Shqipëria mori 50 pikë në vlerësimin e fundit mbi nivelin e Lirisë së Medias nga Freedom House, një vlerësim ky që e rradhit vendin tonë në listën e vendeve me media **Pjesërisht të Lira**. Të gjitha vendet e rajonit u vlerësuan më shumë se Shqipëria përse i përket statusit të lirisë së medias.

Shkaqet që na kanë klasifikuar te vendet Pjesërisht të Lira janë:

- Media e ndarë në mbështetës të Maxhorancës dhe Mbështetës të Opozitës
- Media e varur financiarisht nga grupe kompanish me interesa publike
- Treg reklamash i përqendruar në tre-katër reklamues të mëdhenj
- Gazetarë që ushtrojnë autocenzurën
- Gazetarë që nuk e kanë të sigurtë vendin e punës
- Gazetarë që nuk njohin dhe nuk shfrytëzojnë të drejtat e tyre ligjore
- Gazetat dhe televizionet nuk kanë transparencë mbi pronësinë dhe financimin. Asnjëra prej tyre nuk ka publikuar asnjëherë bilancin e vet.



Gjetjet kryesore rajonale përfshijnë:

Europa Qëndrore dhe Lindore / Ish Bashkimi Sovietik: Ky rajon shënoi përkeqësimin më të madh mes rajoneve, ku Rusia, Gjeorgja, Kirgizistani dhe shumë vende të Europës Qëndrore, mes të tjerave, paraqitën rënie. Vetëm 18% e qytetarëve të rajonit jetojnë në kushtet e Medias së Lirë.

Europa Perëndimore: Rajoni vijoi të ketë nivelin më të lartë të lirisë së medias në shkallë botërore, pavarësisht përkeqësimit në Portugali, Maltë dhe Turqi, i vetmi vend në rajon i klasifikuar si Pjesërisht i Lirë.

METODOLOGJIA

Renditja dhe raportet e përfshira në publikimin Liria e Medias 2008 mbulojnë ngjarje që kanë ndodhur mes 1 Janarit 2007 dhe 1 Dhjetorit 2007

Vendeve u jepen pikët nga 0 (më e mira) te 100 (më e keqja) në bazë të një seti me 23 pyçështje metodologjike të ndara në tre nënkategori. Duke i dhënë pikë numerike, krijohet mundësia për analizë krahasuese mes vendeve të vëzhguara dhe lehtëson ekzaminimin e tendencës përgjatë viteve. Shkalla në të cilën secili vend lejon qarkullimin e lirë të lajmeve dhe informacioneve përcakton klasifikimin e medias si "E lirë", "Pjesërisht e Lirë" ose "Jo e lirë". Vendet që marrin nga 0 në 30 pikë vlerësohen si "Të lira"; 31 deri në 60, "Pjesërisht të Lira"; dhe 61 deri në 100, si vende me media "Jo të lirë".

Ekzaminimi i nivelit të lirisë së medias në secilin vend sëfundmi përfshin 23 çështje metodologjike të ndara në tre kategori të mëdha: klima ligjore, klima politike dhe klima ekonomike. Secili vend vlerësohet në këto tre kategori, ku numrat më të mëdhenj tregojnë liri më të ulët. Pikët finale të një vendi bazohen në shumën totale të marrë në këto tre kategori: Një

pikë mes 0 dhe 30, e vendos vendin në grupin e vendeve të lira; 31 deri në 60 te lista e vendeve Pjesërisht të Lira; dhe 61 deri në 100 te grupi i vendeve pa Liri Medie.

Procesi i kërkimit dhe renditjes përfshin 38 analistë dhe 11 këshilltarë të lartë të renditjes

Konkluzionet e tyre nxirren pasi kanë mbledhur informacion nga kontakte me profesionistë në vende të ndryshme, me udhëtime të stafit apo konsulentëve, vizitorëve ndërkombëtar, raportimeve të organizatave të lirisë së medias dhe të drejtave të njeriut, specialistëve në zonat gjeografike dhe gjeostrategjike, raporteve të qeverive dhe organizmave shumëpalëshe si dhe prej medias së ndryshme vendore e ndërkombëtare.

FORUM

Në këtë Workshop morën pjesë 25 përfaqësues të OJQ-ve dhe Medias, të cilët diskutuan mbi zhvillimin e lirisë së shtypit në Shqipëri në bazë të rezultateve të Indeksit të publikuar duke arritur në disa konkluzione dhe rekomandime:

1. Media vuan si të gjitha bizneset e tjera nga mungesa e ndarjes së pronësisë nga menaxhimi i biznesit.
2. Media vuan kontrollin e politikës në jetën ekonomike të vendit, eg. Monopoli ligjor i autoriteteve shtetërore në lejet për sektorin e ndërtimit.
3. Ekzistenca e monopoleve/oligopoleve ligjore në sektorët strategjik.
4. Ekzistenca e reklamës për të të mbyllur gojën dhe jo e reklamës si mjet marketingu.
5. Lidhja e fortë mes suksesit ekonomik dhe mbështetjes politike.



6. Tradita e pranimit të medias nga ana e lexuesve si zëdhënëse e pushtetit.
7. Subvencionimi direkt ose indirekt nga ana e institucioneve shtetërore të mediave të ndryshme eg. Televizioni Publik Shqiptar.
8. Ekzistenca e KKRT-së si institucion produkt i politikës

MENDIMI EKSPERTIT

- Përsa i përket rolit të Televizionit Publik Shqiptar, Z.Lutfi Dervishi, gazetar i pavarur, shprehu mendimin se një televizion publik është i nevojshëm për të prodhuar programe që kanë vlera të larta për kulturën kombëtare por që nuk mbartin vlera të konsiderueshme komerciale.
- Përsa i përket rrugëzgjdhjeve, Z. Aleksandër Cipa, Kryetar i Bashkimit të Gazetarëve Shqiptarë, shprehu shqetësimin për mungesën e angazhimit të gazetarëve për kërkimin e të drejtave të tyre ligjore, pasqyruar kjo në mungesën e ekzistencës së sindikatave të gazetarëve në organet mediatike shqiptare.
- Z. Gerti Shella, gazetarë i pavarur, shprehu mendimin se shumë gazetarë nuk anëtarësohen në sindikata për shkak të bindjes që kanë për vetërregullimin e tregut.
- Të gjithë të pranishmit qenë darkod mbi faktin se problemet e medias në Shqipëri vlerësohet se kanë një burim të përbashkët me problemet e të gjithë shoqërisë dhe përfshijnë kontrollin e tepruar të politikës dhe organizmave qeveritare në jetën publike të vendit, ekzistencën e monopoleve/oligopoleve thuajse ligjore në shumë sektorë të jetës ekonomike, përfshirë nevojën për derregullim në sektorin e ndërtimit, atë të telekomunikacioneve etj.

VEPRIMTARI NË MUAJIN E ARDHSHËM

- ✓ **Forum "Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale 2008 - 2009"**
World Economic Forum
- ✓ **Konkurs "ESE"**
 - *Thirrje per Aplikime nga Studente te Fakultetit te Ekonomise dhe Fakultetit te Shkenca Sociale*
- ✓ **Ndërtimi dhe përditësimi i databazës së Indekseve në faqen e Internetit të ACER**
 - *Me Forume online për të nxitur diskutime mbi përdorimin dhe besueshmërinë e Indekseve*
 - *Për tu informuar mbi Metodologjitë e Indekseve më të rëndësishme dhe publikimin vjetor të tyre*
 - *Për tu informuar mbi organizimin dhe rezultatet e Forumeve Publike*

Për tu informuar me shumë rreth publikimeve të Indekseve dhe metodologjive e materialeve të aktiviteteve na vizitoni në faqen tonë të Internetit

www.acer.org.al

ose regjistrohuni ne
acer@icc-org.al